

EGI GROUP Sh.p.k përmes aktivitetit kryesor, prodhimi i pastave (brumrave), përpunimi i kikirikave, çoko kemit, flipsave, çipsave dhe biskotave, dëshirojmë të prodhojmë produkte të sigurta dhe me cilësi të lartë, krijojmë besnikëri të konsumatorit, dhe të **biznesit me parime etike**. Kompania është e zotuar të zbatoj sistemin e Menaxhimit me cilësi dhe siguri të ushqimit sipas parimeve të GFSI (IFS FOOD Ver.7), të angazhuar për të **prodhuar produkte të sigurta, cilësore**, duke futur praktikën më të mirë të prodhimit që do të plotësojnë kërkesat e ligjit, procesit, specifikimit dhe të tregut.

EGI GROUP Sh.p.k është e angazhuar për trajnimin e vazhdueshëm të punëtorëve, përmirësimin e kualitetit të produkteve dhe zbatimin e praktikave të mira të prodhimit. Përkushtim të veçantë të përzgjedhja e furnitorëve, lëndës së parë, përpunimit si dhe rruajtja e mjedisit.

Një ekip i përbërë prej stafit shumë të motivuar të përcaktuar për ofrimin e produkteve dhe shërbimeve të nivelit më të lartë. Forca jonë buron nga **përkushtimi ndaj klientëve/blerësve**, partnerëve, punëtorëve, ndaj vetvetes si dhe **kultures së sigurisë së ushqimit**.

Qëllimi ynë është ofrimi i produkteve dhe shërbimeve cilësore dhe të sigurta që i përmbushin plotësisht kërkesat e klientëve tanë dhe kërkesat ligjore, sigurimi i një **gjendje të qëndrueshme** financiare dhe përmbushja e interesave të pronarëve të ndërmarrjes.

Nëpërmjet zbatimit të sistemit të menaxhimit të cilësisë dhe sigurisë së ushqimit në mënyrë korrekte, etike, përgjegjësi personale dhe sipas parimeve të GFSI (IFS FOOD Ver.7), do të arrijmë përmbushjen e kërkesave të klientit, produktit dhe shërbimit, pronarëve, punonjësve dhe shoqërisë në përgjithësi.

Aspektet kryesore mjedisore (për EN ISO 14001): që tregon se kompania identifikon aspektet mjedisore të lidhura me aktivitetet, produktet dhe shërbimet e tyre, për të përcaktuar aspektet e rëndësishme të mjedisit dhe përdoren metodat e monitorimit dhe mbikëqyrja efektive

Kompania është duke respektuar aspekte ambiente dhe është e harmonizuar me kërkesat e ministrisë së mjedisit të Republikës së Kosovës.

Për të arritur qëllimin tonë menaxhmenti dhe punëtorët e **EGI GROUP Sh.p.k** janë të obliguar që të:

- Përmbushin kërkesat, nevojat dhe pritshmëritë e klientit, sipas **specifikave** të kërkuara;
- Veprojnë sipas përgjegjësisë të ndara dhe procedurave të përcaktuara;
- Përmbushin në vazhdimësi kërkesat që dalin nga direktivat evropiane për produktet;
- Punojnë në vazhdimësi për përmirësimin e efektivitetit dhe efikasitetit të **proceseve punuese** dhe aftësive të personelit;
- Veprojnë në mënyrë preventive me qëllim të evitimit të jokonformiteteve;
- Njohin, zbatojnë dhe rishikojnë politikën e menaxhimit të cilësisë dhe sigurisë ushqimore.

Obligimet e vendosura mund të arrihen vetëm me dije, profesionalizëm, përvojë dhe motivim të punëtorëve tanë, ngritjen e aftësive të tyre gjithashtu edhe përcjelljes së zhvillimit teknologjik dhe kërkesave të tregut.

Pejë, 01.03.2023

Drejtor Ekzekutiv: Argëzon Havolli